

ALBANIAN RAILWAYS JOB DESCRIPTION

CIVIL ENGINEER

Project Background

Hekurudha Shqiptare (HSH) is implementing the Vorë–Hani i Hotit Railway Rehabilitation Project through its dedicated Project Implementation Unit (PIU). The Project is co-financed by the European Bank for Reconstruction and Development (EBRD), the European Investment Bank (EIB), and the grant from Western Balkans Investment Framework (WBIF). The Project represents a strategic investment in the modernization of Albania's railway infrastructure and the enhancement of regional connectivity along the Trans-European Transport Network (TEN-T).

The Project aims to rehabilitate and modernize approximately 120 km of the existing railway line between Vorë and Hani i Hotit, enhancing railway safety, operational performance, and connectivity with the European railway network. The Project is being implemented under a Design and Build Contract in accordance with the Financing Agreements, international engineering standards, and FIDIC Conditions of Contract.

Purpose

The Civil Engineer will support the Project Implementation Unit (PIU) of the Vorë–Hani i Hotit Railway Project in the technical management, coordination, and contract administration of the Project. The position will provide technical support throughout all stages of project implementation, including the procurement process, the review of the Contractor's design deliverables, construction, commissioning, and the Defects Notification Period.

The Civil Engineer will coordinate and monitor the implementation of Project activities, monitor the performance of the Supervision Consultant (the Engineer) and the Works Contractor, review technical deliverables and progress reports, support the administration of works and consultancy contracts, provide technical advice to the PIU, support stakeholder coordination and community liaison activities, and coordinate with relevant stakeholders to facilitate the timely resolution of technical and contractual matters. The Civil Engineer will contribute to ensuring that the Project is implemented in accordance with the contractual requirements, the Employer's Requirements, approved design documentation, applicable technical standards, and the Financing Agreements, thereby supporting the successful and timely delivery of the Project.

Operating Network

In this position, the Civil Engineer will report directly to the Head of PIU of Vorë- Hani i Hotit Project and Project Management Implementation Unit (PMIU) Director, cooperate closely with colleagues working within the PIU, PMIU and HSH and occasionally with the IFI officers in charge of the Project.

The Civil Engineer will report to the Head of PIU of Vorë–Hani i Hotit Project and work in close coordination with the PMIU Director. The position will cooperate closely with colleagues within the PIU, PMIU and HSH, as well as with PIU Support (Technical Assistance Consultant), government institutions, utilities, local authorities and, where required, representatives of the International Financial Institutions (EBRD, EIB and WBIF).

Accountabilities

The Civil Engineer shall be responsible for:

- Working closely with the Vora-Hani i Hotit PIU team to support the implementation of the Vora-Hani i Hotit Project and the achievement of its objectives, milestones and deliverables.
- Monitoring Project implementation against the approved work plans, implementation schedules and contractual requirements, and contributing to the preparation of progress reports, implementation plans, payment forecasts and other reports required under the Financing Agreements.
- Reviewing technical submissions, reports and deliverables prepared by the Works Contractor including its Designer and the Supervision Consultant and, providing technical recommendations to the PIU regarding compliance with the Employer's Requirements, applicable engineering standards and contractual obligations.
- Providing technical input during the review of engineering designs, technical studies and consultancy deliverables, ensuring consistency with the Project objectives, applicable standards and contractual requirements.
- Monitoring the performance of the Supervision Consultant and Works Contractor on behalf of the Employer, identifying implementation issues and recommending appropriate corrective actions to the Head of PIU.
- Conducting regular site visits to monitor the progress of the Works, verify implementation status and report significant technical, contractual or implementation issues to the PIU.
- Supporting the administration and implementation of works and consultancy contracts, including the review of variations, claims, technical proposals and other contractual documentation, as required.
- Supporting the PIU in ensuring that Project implementation complies with the Financing Agreements, applicable procurement requirements, HSH procedures and the legislation of the Republic of Albania.
- Coordinating with relevant public authorities, utility companies, local governments and other stakeholders to facilitate the timely implementation of Project activities.
- Representing HSH, as requested, in meetings, technical working groups, workshops and coordination forums with government institutions, International Financial Institutions, consultants, contractors and other stakeholders.
- Performing any other duties consistent with the nature of the position, as may reasonably be assigned by the Head of PIU.

Qualifications

The candidate shall possess:

- Master's (University) degree in Civil Engineering, or another relevant field.
- Minimum ten (10) years of professional experience in civil engineering, including experience in internationally financed infrastructure projects.
- Minimum five (5) years of experience in the implementation, supervision or contract administration of major infrastructure projects.
- Good working knowledge of local and international engineering design standards and construction practices.
- Excellent written and verbal communication skills in both English and Albania.
- Proficiency in Microsoft Office applications.

The following qualifications will be considered an asset:

- Experience in projects financed by EBRD, EIB, World Bank, EU or other International Financial Institutions.
- Knowledge of FIDIC Conditions of Contract for Construction.
- Experience in contract administration and project implementation under FIDIC-based contracts.
- Experience with AutoCAD or other engineering software.
- Strong analytical, organizational and problem-solving skills, with the ability to manage multiple tasks and meet deadlines with minimum supervision.

**HEKURUDHA SHQIPTARE (HSH)
PËRSHKRIMI I POZICIONIT**

INXHINIER CIVIL

Informacion mbi Projektin

Hekurudha Shqiptare (HSH) po zbaton Projektin për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë–Hani i Hotit nëpërmjet Njesisë së Zbatimit të Projektit (PIU). Projekti bashkëfinancohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe nga një grant nga Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Projekti përfaqëson një investim strategjik për modernizimin e infrastrukturës hekurudhore në Shqipëri dhe përmirësimin e lidhjes rajonale përgjatë Rrjetit Gjithëpërfshirës Trans-Evropian të Transportit (TEN-T).

Projekti synon rehabilitimin dhe modernizimin e rreth 120 km të linjës ekzistuese hekurudhore ndërmjet Vorës dhe Hanit të Hotit, me qëllim përmirësimin e sigurisë hekurudhore, performancës operacionale dhe lidhjes me rrjetin hekurudhor evropian. Projekti zbatohet nëpërmjet një kontrate **Projektim dhe Ndërtim (Design and Build)**, në përputhje me Marrëveshjet e Financimit, standardet ndërkombëtare të inxhinierisë dhe Kushtet e Kontratës FIDIC.

Qëllimi i Pozicionit

Inxhinieri Civil do të mbështesë Njësinë e Zbatimit të Projektit (PIU) të Projektit Hekurudhor Vorë–Hani i Hotit në menaxhimin teknik, koordinimin dhe administrimin e kontratës së Projektit. Pozicioni do të ofrojë mbështetje teknike gjatë të gjitha fazave të zbatimit të Projektit, duke përfshirë procesin e prokurimit, shqyrtimin e dokumentacionit të projektimit të përgatitur nga Kontraktori, fazën e ndërtimit, komisionimin dhe Periudhën e Njoftimit të Defekteve (Defects Notification Period).

Inxhinieri Civil do të koordinojë dhe monitorojë zbatimin e aktiviteteve të Projektit, do të monitorojë performancën e Konsulentit të Mbikëqyrjes (Inxhinierit) dhe Kontraktorit të Punimeve, do të shqyrtojë dokumentacionin teknik dhe raportet e progresit, do të mbështesë administrimin e kontratave të punimeve dhe të konsulencës, do të ofrojë këshillim teknik për PIU-në, do të mbështesë koordinimin me palët e interesit dhe komunikimin me komunitetin, si dhe do të bashkëpunojë me institucionet dhe aktorët përkatës për zgjidhjen në kohë të çështjeve teknike dhe kontraktuale. Inxhinieri Civil do të kontribuojë për të siguruar që Projekti të zbatohet në përputhje me kërkesat kontraktore, Kërkesat e Punëdhënësit (Employer's Requirements), dokumentacionin e miratuar të

projektimit, standardet teknike në fuqi dhe Marrëveshjet e Financimit, duke mbështetur realizimin me sukses dhe në kohë të Projektit.

Raportimi i Punës

Inxhinieri Civil do t'i raportojë drejtpërdrejt Drejtuesit të PIU Vorë–Hani i Hotit dhe do të punojë në koordinim të ngushtë me Drejtorin e Njësisë së Menaxhimit dhe Zbatimit të Projekteve (PMIU).

Inxhinieri Civil do të bashkëpunojë ngushtë me kolegët në PIU, PMIU dhe të Hekurudhës Shqiptare (HSH), si dhe me ekipin e Konsulentit Mbështetës të PIU (Konsulent i Asistencës Teknike), institucionet shtetërore, shoqëritë e shërbimeve publike, njësitë e qeverisjes vendore dhe, sipas nevojës, me përfaqësuesit e institucioneve financiare ndërkombëtare (EBRD, EIB dhe WBIF).

Përgjegjësitë Kryesore

Inxhinieri Civil do të jetë përgjegjës për:

- Bashkëpunimin e ngushtë me ekipin e PIU Vorë–Hani i Hotit për të mbështetur zbatimin e Projektit dhe arritjen e objektivave, etapave kryesore dhe rezultateve të tij.
- Monitorimin e zbatimit të Projektit në përputhje me planet e miratuara të punës, programet e zbatimit dhe kërkesat kontraktore, si dhe kontributin në përgatitjen e raporteve të progresit, planeve të zbatimit, parashikimeve të pagesave dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Marrëveshjet e Financimit.
- Shqyrtimin e dokumentacionit teknik, raporteve dhe produkteve të përgatitura nga Kontraktori i Punimeve, përfshirë Projektuesin e tij, si dhe nga Konsulenti i Mbikëqyrjes, dhe dhënien e rekomandimeve teknike për PIU lidhur me përputhshmërinë me Kërkesat e Punëdhënësit, standardet inxhinierike dhe detyrimet kontraktore.
- Dhënien e kontributit teknik gjatë shqyrtimit të projekteve inxhinierike, studimeve teknike dhe produkteve të konsulencës, duke siguruar përputhshmërinë me objektivat e Projektit, standardet në fuqi dhe kërkesat kontraktore.
- Monitorimin, në emër të Punëdhënësit, të performancës së Konsulentit të Mbikëqyrjes dhe Kontraktorit të Punimeve, identifikimin e problematikave gjatë zbatimit dhe rekomandimin e masave korrigjuese për Drejtuesin e PIU.
- Kryerjen e vizitave periodike në kantier për monitorimin e ecurisë së punimeve, verifikimin e statusit të zbatimit dhe raportimin pranë PIU të çështjeve të rëndësishme teknike, kontraktore ose të zbatimit.
- Mbështetjen e administrimit dhe zbatimit të kontratave të punimeve dhe të konsulencës, përfshirë shqyrtimin e ndryshimeve, pretendimeve, propozimeve teknike dhe dokumentacionit tjetër kontraktor, sipas nevojës.
- Mbështetjen e PIU për të siguruar që zbatimi i Projektit të jetë në përputhje me Marrëveshjet e Financimit, kërkesat e zbatueshme të prokurimit, procedurat e HSH-së dhe legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- Koordinimin me institucionet publike, shoqëritë e shërbimeve publike, njësitë e qeverisjes vendore dhe palët e tjera të interesit për të mundësuar zbatimin në kohë të aktiviteteve të Projektit.
- Përfaqësimin e HSH-së, sipas kërkesës, në takime, grupe teknike pune, seminare dhe forume koordinuese me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, konsulentët, kontraktorët dhe palët e tjera të interesit.
- Kryerjen e çdo detyre tjetër në përputhje me natyrën e pozicionit, sipas kërkesës së arsyeshme të Drejtuesit të PIU.

Kualifikimet

Kandidati duhet të zotërojë:

- Diplomë universitare **Master** në Inxhinieri Ndërtimi ose në një fushë tjetër të ngjashme.
- Minimumi dhjetë (10) vite përvojë profesionale në fushën e inxhinierisë civile, përfshirë përvojë në projekte infrastrukturore të financuara nga institucione financiare ndërkombëtare.
- Minimumi pesë (5) vite përvojë në zbatimin, mbikëqyrjen ose administrimin e kontratave të projekteve të mëdha infrastrukturore.
- Njohuri të mira të standardeve vendase dhe ndërkombëtare të projektimit inxhinierik dhe praktikave të ndërtimit.
- Aftësi shumë të mira komunikimi me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Njohuri të mira në përdorimin e paketës Microsoft Office.

Kualifikimet e mëposhtme do të përbëjnë avantazh:

- Përvojë në projekte të financuara nga EBRD, EIB, Banka Botërore, Bashkimi Evropian ose institucione të tjera financiare ndërkombëtare.
- Njohuri mbi Kushtet e Kontratës FIDIC për punimet e ndërtimit.
- Përvojë në administrimin e kontratave dhe zbatimin e projekteve sipas kontratave të bazuara në FIDIC.
- Përvojë në përdorimin e AutoCAD ose programeve të tjera inxhinierike.
- Aftësi të forta analitike, organizative dhe në zgjidhjen e problemeve, si dhe aftësi për të menaxhuar njëkohësisht disa detyra dhe për të përmbushur afatet me mbikëqyrje minimale.

ALBANIAN RAILWAYS JSC

DURRËS, 29/07/2026

JOB VACANCY

Albanian Railways JSC announces to interested candidates the vacant position of:

Civil Engineer

Vora–Hani i Hotit Project Implementation Unit (PIU)

Project Management and Implementation Directorate (PMIU)

General Candidate Criteria:

1. Be an Albanian citizen and have full legal capacity to act.
2. Be in a health condition that allows the performance of the relevant duties.
3. Not have been convicted by a final court decision for the commission of a criminal offence.
4. Not be subject to a disciplinary measure of dismissal from employment that has not been expunged in accordance with the legislation in force.
5. Possess the educational background, professional qualifications and experience required for the respective position.

The deadline for submission of the documentation is 07/08/2026.

Address:

Albanian Railways JSC
Directorate of Internal Support Services
Egnatia Street, No. 3, Building No. 8, Durrës

Specific Criteria for the Position:

- a. Master's university degree in Civil Engineering or in another similar field.
- b. Minimum ten (10) years of professional experience in the field of civil engineering, including experience in infrastructure projects financed by International Financial Institutions.
- c. Minimum five (5) years of experience in the implementation, supervision or administration of contracts for major infrastructure projects.
- d. Good knowledge of national and international engineering design standards and construction practices.
- e. Good knowledge in the use of the Microsoft Office package.
- f. Possess the necessary cooperation skills for coordinating work with other HSH Units and third parties.
- g. Possess knowledge of the English language at working level (minimum B1 level).
- h. Have the ability to understand and use technical and professional documentation in the English language.

- i. Be willing to carry out site inspections, technical inspections and business travel according to the needs of the position.
- j. Demonstrate high professional integrity, work ethics and the ability to maintain the confidentiality of official information.

The following qualifications shall constitute an advantage:

- Experience in projects financed by the EBRD, EIB, the World Bank, the European Union or other International Financial Institutions.
- Knowledge of the FIDIC Conditions of Contract for Construction.
- Experience in contract administration and implementation of projects under FIDIC-based contracts.
- Experience in the use of AutoCAD or other engineering software.
- Strong analytical, organizational and problem-solving skills, as well as the ability to manage multiple tasks simultaneously and meet deadlines with minimal supervision.

List of documents to be submitted by the candidate as follows:

- Application Request (Letter of Interest addressed to the Institution);
- Detailed and updated Curriculum Vitae (CV);
- Photocopy of the Identity Card or Passport;
- Photocopy of the university diploma and diploma supplement/transcript of records;
- Documentation proving professional experience (employment record book, employment certificates or extract from the social insurance records);
- Criminal Record Certificate (may be submitted by the successful candidate before appointment);
- Photocopies of certificates, training records or professional qualifications, if available;
- Any other document that the candidate considers valuable for the evaluation of the application.

The procedure to be followed is open to everyone and the selection criteria shall be applied by the Selection Committee.

Interviews with candidates who meet the criteria and pass the preliminary documentation evaluation stage shall be held in Durrës, No. 3, General Directorate Building of Albanian Railways JSC.

THANK YOU!

ALBANIAN RAILWAYS JSC

HEKURUDHA SHQIPTARE SH.A.

DURRËS, 29/07/2026

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Shoqëria Hekurudha Shqiptare sh.a. njofton kandidatët e interesuar për vendin vakant të punës në pozicionin:

Inxhinier Ndërtimi

Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU) Vorë-Han i Hotit

Drejtoria e Menaxhimit dhe Zbatimit të Projekteve (PMIU)

Kriteret e përgjithshme të kandidatit:

1. Të jetë shtetas shqiptar dhe të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë ushtrimin e detyrës përkatëse.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
4. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, e pafshirë sipas legjislacionit në fuqi.
5. Të ketë përgatitjen arsimore, profesionale dhe përvojën e kërkuar për pozicionin përkatës.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është data 07/08/2026.

Adresa:

Hekurudha Shqiptare sh.a.

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse

Rr. Egnatia, Lagjja Nr. 3, Godina Nr. 8, Durrës

Kriteret e veçanta të pozicionit të punës:

- a. Diplomë universitare **Master** në Inxhinieri Ndërtimi ose në një fushë tjetër të ngjashme.
- b. Minimumi dhjetë (10) vite përvojë profesionale në fushën e inxhinierisë civile, përfshirë përvojë në projekte infrastrukturore të financuara nga institucione financiare ndërkombëtare.
- c. Minimumi pesë (5) vite përvojë në zbatimin, mbikëqyrjen ose administrimin e kontratave të projekteve të mëdha infrastrukturore.
- d. Njohuri të mira të standardeve vendase dhe ndërkombëtare të projektimit inxhinierik dhe praktikave të ndërtimit.
- e. Njohuri të mira në përdorimin e paketës Microsoft Office.
- f. Të zotërojë aftësi bashkëpunimi të domosdoshme për rakordimin e punës me Njësitë e tjera në HSH dhe palët e treta.
- g. Të zotërojë njohuri të gjuhës angleze në nivel pune (minimumi niveli B1).
- h. Të ketë aftësi për të kuptuar dhe përdorur dokumentacion teknik dhe profesional në gjuhën angleze.
- i. Të jetë i gatshëm për kryerjen e inspektimeve në terren, kontrolleve teknike dhe udhëtimeve të punës sipas nevojave të pozicionit.
- j. Të gëzojë integritet të lartë profesional, etikë në punë dhe aftësi për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit zyrtar.

Kualifikimet e mëposhtme do të përbëjnë avantazh:

- Përvojë në projekte të financuara nga EBRD, EIB, Banka Botërore, Bashkimi Evropian ose institucione të tjera financiare ndërkombëtare.
- Njohuri mbi Kushtet e Kontratës FIDIC për punimet e ndërtimit.
- Përvojë në administrimin e kontratave dhe zbatimin e projekteve sipas kontratave të bazuara në FIDIC.
- Përvojë në përdorimin e AutoCAD ose programeve të tjera inxhinierike.
- Aftësi të forta analitike, organizative dhe në zgjidhjen e problemeve, si dhe aftësi për të menaxhuar njëkohësisht disa detyra dhe për të përmbushur afatet me mbikëqyrje minimale.

Lista e dokumentacionit të punës, për t'u dorëzuar nga kandidati/ja si vijon:

- Kërkesë për aplikim (Letër Interesi drejtuar institucionit);
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar dhe e përditësuar;
- Fotokopje e Kartës së Identitetit ose Pasaportës;
- Fotokopje e diplomës universitare dhe suplementit/listës së notave;
- Dokumentacion që vërteton përvojën profesionale (librezë pune, vërtetime pune ose ekstrakt i sigurimeve shoqërore);
- Dëshmi Penaliteti (mund të paraqitet nga kandidati fitues para emërimit);
- Fotokopje të certifikatave, trajnimeve ose kualifikimeve profesionale, nëse disponohen;
- Çdo dokument tjetër që kandidati e gjykon të vlefshëm për vlerësimin e aplikimit.

Procedura që do të ndiqet është e hapur për të gjithë dhe kriteret e përzgjedhjes do të zbatohen nga Komisioni Përzgjedhës.

Intervista me kandidatët që plotësojnë kriteret dhe kalojnë fazën e vlerësimit paraprak të dokumentacionit do të zhvillohet në Durrës, Lagjja Nr. 3, Godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudha Shqiptare sh.a.

JU FALEMINDERIT!

HEKURUDHA SHQIPTARE SH.A.